



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 351/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për kërkesën e Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

### V E N D I M

**Konstatohen të tërhequra ankesat** me numër: Anr.307/2013, Anr.308/2013 Anr.310/2013 të datës 22.10.2013, të parashtruar në PZAP nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

### Arsyetim

PZAP, me datë 25.10.2013, ka pranuar një kërkesë për tërheqjen e ankesave me numër: Anr. 307/2013, Anr. 308/2013 Anr. 310/2013 të datës 22.10.2013, të parashtruara në PZAP, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në të cilën kërkohet që të tërhiqet ankesa e lartpërmendur nga shqyrtimi, pasi që ky subjekt politik ka ndermar veprimet për evitimin e shkeljes së pretenduar PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqje të ankesës së sipërshtënuar, me të cilën kërkohet nga PZAP-i që mos të shqyrtohet ankesa në fjalë, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 351/2013 më datën 25.10.2013

Kryesuesi i Panelit  
Nehat Idrizi

